



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Zhvillimit Rajonal
Ministarstvo za Regionalni Razvoj
Ministry of Regional Development

Prishtinë, data 03.02.2020

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregulloren Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil, si dhe Rregulloren Nr. 21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nëpunësve Civilë, Ministria e Zhvillimit Rajonal shpall:

KONKURS
TË BRENDSHËM PËR AVANCIM

Titulli i vendit të punës:	Udhëheqës i Divizionit për Koordinim të Politikave
Departamenti:	Integrimi Evropian dhe Koordinim të Politikave
Divizioni:	Koordinim të Politikave
Orari i punës:	I plotë /40 orë në javë
Koeficienti:	9
Raporton te:	Drejtori i Departamentit
Lloji i pozitës	I/E karrierës
Procedura e Aplikimit:	I brendshëm
Numri i zyrtarëve:	1
Numri i referencës:	IE/060

Qëllimi i vendit të punës:

Përkrahja në bashkërendimin e procesit të planifikimit strategjik, zhvillimit të politikave dhe reformës së zhvillimit rajonal.

Detyrat kryesore

1. Të menaxhojë me stafin përmes delegimit efikas të detyrave dhe të përgjegjësive me qëllim të përmbushjes së planeve dhe detyrave të punës, ndihmon dhe këshillon në përcaktimin dhe vendosjen e prioriteteve strategjike të Ministrisë në pajtim me prioritetet e Qeverisë; 20%
2. Të koordinoj punën në zhvillimin e dokumenteve kryesore strategjike të cilat hartohen nga strukturat e ministrisë, duke siguruar që këto dokumente të jenë në pajtim me politikën dhe prioritetet e Qeverisë si dhe siguron konsistencën mes tyre; 20%

3. Ndhomon strukturat politikë-bërëse të ministrisë në përgatitjen e koncept dokumenteve për legjislacion të cilat duhet të reflektojnë në politikat sektoriale dhe ato të Qeverisë;15%
4. Bashkërendon në sigurimin e kontributeve për zhvillimin e Planin Vjetor të Punës dhe siguron harmonizimin e tyre me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe dokumente tjera strategjike; 10%
5. Monitoron zbatimin e Planit Vjetor të Punës dhe raporton tek institucionet relevante, me theks të veçantë tek ZKM, ndihmon strukturat tjera të ministrisë nga aspekti metodologjik në hartimin e dokumenteve strategjike dhe atyre të politikave; 10%
6. Koordinon punën dhe bashkëpunon me menaxheret tjerë në intitucion;10%
7. Ndhomon monitorimin dhe raportimin e zbatimit të planit zhvillimor institucional të Ministrisë, si dhe aktiviteteve tjera për reformimin institucional të ministrisë dhe përgatitë raporte periodike të punës së divizionit;10%
8. Bën vlerësim të rregull të stafit nën mbikëqyrje të tij/saj dhe përkrahë zhvillimin e tyre përmes trajnimeve për të siguruar kryerjen e detyrave të tyre në nivel me standardet e kërkuara 5;

Kualifikimet dhe shkathtësitë e kërkuara:

- Diplomë universitare në Drejtësi, Ekonomi, Shkenca shoqërore dhe Administratë publike;
- Së paku 5 vite përvojë pune profesionale.
- Njohuri të përgjithshme të legjislacionit në Vetëqeverisje lokale, dhe njohuri të çështjeve të koordinimit të politikave;
- Njohje e Institucioneve dhe e politikave të BE-së;
- Njohje e Rregulloreve mbi fondet strukturore evropiane;
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe si pjesë e ekipit (punë ekipore);
- Shkathtësi të dëshmuara për vizion strategjik, shkathtësi dhe aftësi për planifikimin dhe për zbatimin e planeve;
- Aftësi për të punuar në një mjedis shumë-kulturor / ndërkombëtar;
- Njohje e gjuhës zyrtare;
- Njohje e gjuhës angleze e preferuar,
- Njohje e kompjuterit (Microsoft Office, Internet).

Aktet ligjore dhe nën-ligjore që e rregullojnë rekrutimin:

Rekrutimin e nëpunësve civil e rregullon Ligji Nr. 03/L-149, për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Rregullorja Nr.02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil dhe Rregulloren Nr.21/2012 për Avancimin në Karrierë të Nënpunësve Civilë.

Kohëzgjatja e emërimit

Kohëzgjatja e emërimit-punësimit është në përputhje me LSHCK Nr. 03/L-149,

Procedurat e konkurrimit:

Procedura e konkurrimit është e brendshme vetëm për nëpunësit civil të MZHR-së. MZHR, ofron mundësi të barabarta të avancimit për të gjithë nëpunësit civil ekzistues brenda MZHR-së.

Kushtet e pjesëmarrjes në konkurs:

Aplikacionet e plotësuar së bashku me kopjet e dëshmive për kualifikimet e nevojshme arsimore të noterizuarë, përvojën e punës, kurset e ndjekura, referencat etj, mundë të dorëzohen drejtpërdrejtë në Divizionin e Burimeve Njerëzore të MZHR-së dhe përmes postës.

Paraqitja e kërkesave:

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve: Ministria e Zhvillimit Rajonal - Divizioni për Burime Njerëzore, Ndërtesa e MZHR-së në Lagjen Pejton Rr. Perandori Justinian Nr. 116 Prishtinë, ose mund të shkarkohen në ueb-faqen zyrtare të MZHR-së. Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të

merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda 2 ditësh; aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe aplikacionet e mangëta refuzohen. Aplikacionet e dorëzuara nuk kthehen!

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë kalendarike, nga dita e publikimit 03.02.2020 deri 10.02.2020

Për informata më të hollësishme mund ta kontaktoni Divizionin e Burimeve Njerëzore.

Tel. 038 200 64504, prej orës 8:00 – 16:00.

www.mzhr.rks-gov.net